

# L I G J

Nr.8503, date 30.6.1999

## PER TE DREJTEN E INFORMIMIT PER DOKUMENTET ZYRTARE

Ne mbeshtetje te neneve 23, 17, 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave

### K U V E N D I

#### I REPUBLIKES SE SHQIPERISE V E N D O S I:

#### KREU I

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

##### Objekti

Ky ligj rregullon te drejten e informimit per dokumentet zyrtare.

##### Neni 2

##### Perkufizimet

Per qellimet e ketij ligji termat e meposhtem kane kuptimet si vijon:

- a) me "autoritet publik" kuptohet çdo organ i administrates shteterore dhe i enteve publike;
- b) me "dokument zyrtar" kuptohet dokumenti i çdo lloji, i mbajtur nga autoriteti publik, ne perputhje me rregullat ne fuqi dhe qe ka lidhje me ushtrimin e nje funksioni publik;
- c) me "person" kuptohet çdo person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj;
- ç) me "publik" kuptohet te pakten edhe nje person.

#### KREU II

#### E DREJTA E INFORMIMIT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT PUBLIK

##### Neni 3

##### E drejta e informimit

Çdo person ka te drejte te kerkoje informacion per dokumentet zyrtare, qe kane te bejne me veprimtarine e organeve shteterore dhe te personave qe ushtrojne funksione shteterore, pa qene i detyruar te shpjegoje motivet.

Autoriteti publik eshte i detyruar te jape çdo informacion ne lidhje me nje dokument zyrtar, perveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Çdo informacion per nje dokument zyrtar, qe i eshte dhene nje personi, nuk mund t'i refuzohet asnje personi tjeter qe e kerkon ate, me perjashtim te rastit kur ky informacion perben te dhena vetjake te vete personit, te cilit i eshte dhene informacioni.

#### Neni 4

##### Kufizimi

Nese informacioni i kerkuar per nje dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i leshon kerkuesit nje deklarate me shkrim, ne te cilen tregohen arsyet e mosdhenies se informacionit dhe rregullat ne baze te te cilave ai mund ta kerkoje ate. Nese kufizimi eshte vetem per nje pjese te te dhenave te dokumentit zyrtar, pjesa tjeter nuk i refuzohet kerkuesit.

#### Neni 5

##### E drejta e informimit per subjektin me funksione shteterore

Ëdo person ka te drejte te informohet per te dhenat vetjake te personave qe kryejne funksione shteterore ose sherbime publike, te mbajtura ne nje dokument zyrtar, per aqsa keto te dhena lidhen me cilesi te kerkuara nga ligji ose nga nje akt nenligjor per personat qe i ushtrojne keto detyra.

#### Neni 6

##### Detyrimi per cilesine e sherbimit te informimit

Autoriteti publik nxjerr rregullore dhe krijon lehtesi strukturore e praktike per marrjen nga ana e publikut, ne menyre te sakte, te plote, te pershtatshme e te shpejte te informacionit per dokumentet zyrtare.

#### Neni 7

##### Format e dhenies se informacionit

Kerkuesit i vihet ne dispozicion nje kopje e plote e dokumentit zyrtar, per te cilin kerkon te informohet.

Autoriteti publik, me kerkese te personit te interesuar ose duke sugjeruar vete, mund t'i ofroje kerkuesit forma te tjera te dhenies se informacionit, perfshi formen verbale. Ne çdo rast te tille, kerkuesi jep me shkrim pelqimin per formen e ofruar.

#### Neni 8

##### Dokumentet zyrtare qe vihen ne dispozicion te publikut pa kerkese

Autoriteti publik eshte i detyruar te beje publike dhe te shumefishoje vete, ne sasi te mjaftueshme dhe me formate te pershtatshme, dokumente qe lehtesojne informimin e publikut per:

- a) vendndodhjen e organeve qendrore dhe vendore, vendet, si dhe emrat e punonjesve nga te cilet publiku mund te marre informacion, te paraqese kerkesa apo te marre pergjigje;
- b) rregullat, procedurat dhe menytrat se si mund te merrren formularet e ndryshem, shpjegime per qellimin dhe permbajtjen e tyre apo te dokumenteve dhe te vertetimeve te nevojshme per plotesimin e formulareve;
- c) rregullat e pergjithshme ligjore, sipas te cilave vepron autoriteti publik, politikat e pergjithshme, qe zbaton autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bera ne to;
- ç) shpjegimet e detajuara per metodat dhe procedurat e punes se autoritetit publik.

#### Neni 9

## Dokumente qe pergatiten paraprakisht

Ne perputhje me ligjet, aktet nenligjore dhe rregullat e publikuara prej tij, autoriteti publik parapergatit per shqyrtim apo kopjim, ne pritje te kerkeses nga publiku, dokumente te tilla si:

- a) vendimet perfundimtare per nje fteshtje te caktuar, perfshi qendrimet e pakices, si dhe urdhrat ose udhezimet ne zbatim te tyre;
- b) urdhrat dhe udhezimet e brendshme qe ndikojne ne marredheniet e autoritetit publik me publikun;
- c) kopje te çdo dokumenti zyrtar, i cili i eshte dhene me pare te pakten nje personi, pavaresisht nga formati i tyre dhe qe autoriteti publik beson se do te jete me interes per persona te tjere;
- ç) indeksin apo skedaret e dokumenteve zyrtare.

## Neni 10

### Afati per mospranimin e kerkeses

Autoriteti publik vendos per mospranimin e plote ose te pjesshem te kerkeses brenda 15 diteve nga depozitimi i saj. Ne rastin e mospranimit te kerkeses, pergjigjja negative, e plote ose e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik.

## Neni 11

### Afati per pergjigje

Autoriteti publik ploteson kerkesen brenda 40 diteve nga depozitimi i saj, me perjashtim te rasteve kur ne kete ligj parashikohet ndryshe.

## Neni 12

### Shtyrja e afatit

Ne rast se autoriteti publik e ka te pamundur plotesimin e kerkeses brenda afatit te parashikuar ne nenin 11, per shkak te veçantise se kerkeses ose te nevojës per t'u keshilluar me nje pale te trete, ateherë ai njofton me shkrim palen e interesuar, jo me vonë se 7 dite nga mbarimi i afatit te meparshem, per pamundesine e realizimit te pjesshem ose te plote te kerkeses per informim, si dhe arsyet apo shkaqet qe e kane sjelle ate.

Ne kete rast autoriteti publik i propozon pales se interesuar njerin nga zgjidhjet e meposhtme:

a) Caktimin e nje afati te ri, i cili fillon ne mbarim te afatit te meparshem dhe qe nuk mund te jete me shume se 10 dite, pa te drejte perseritjeje;

b) pershtatjen e kerkeses nga ana e personit, ne menyre te tille, qe te mund te respektohet nga ana e autoritetit publik afati i parashikuar ne kete ligj.

Personi i interesuar zgjedh njerin nga propozimet e mesiperme. Ne rast se personi ne fjale nuk shpreh pelqimin e vet para perfundimit te afatit te pare, autoriteti publik vendos shtyrjen e afatit.

## Neni 13

### Pagesat per sherbimin e informimit

Per kryerjen e sherbimit te informimit per dokumentet zyrtare, nese kjo kerkon shpenzime, autoriteti publik mund te vendose tarifa, te cilat i percakton paraprakisht.

Tarifat per sherbimet standarde ose per ato per te cilat eshte krijuar nje pervoje behen publike. Tarifat per sherbimet e tjera percaktohen rast pas rasti dhe i behen te njohura pales se interesuar ne çastin e pranimit te kerkeses.

Tarifat nuk mund te jene me te larta se kostoja per realizimin e sherbimit. Kjo kosto perfshin vetem shpenzimet materiale per realizimin e sherbimit.

Te dhenat e percaktuara ne nenin 8 jepen pa pagese.

Procedurat dhe vendimet per vendosjen e tarifave per sherbimin e informimit jane ne vetvete dokument zyrtar, ne kuptimin e ketij ligji.

### KREU III

#### ANKIMI

##### Neni 14

#### Rregulli i pergjithshem

Shkelja e dispozitave te ketij ligji, kur nuk perben veper penale, eshte kundervajtje administrative dhe rregullohet ne baze te ligjit nr.7697, date 7.4.1993 "Per kundervajtjet administrative" me plotesimet e mevonshme.

##### Neni 15

#### Ankimi administrativ

Çdo person ka te drejte te ankohet, ne rruge administrative, kur ÷mon se i jane shkelur te drejtat e parashikuara nga ky ligj.

Procedurat e ankimit administrativ rregullohen me ligjin nr.8475, date 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise".

##### Neni 16

#### Ankimi ne gjykate

Çdo person ka te drejte te ankohet ne gjykate kur ÷mon se i jane shkelur te drejtat e parashikuara nga ky ligj.

Per procedurat e ankimit ndiqen dispozitat e Kodit te Procedures Civile, qe rregullojne gjykimin e mosmarreshjeve administrative.

##### Neni 17

#### Shperblimi i demit

Çdo person, qe ka pesuar nje dem per shkak te shkeljes se dispozitave te ketij ligji, ka te drejte te kerkoje shperblimin e demit nga subjekti qe shkel te drejten.

Procedurat per ankim dhe per shperblimin e demit rregullohen me ligj.

### KREU IV

#### DISPOZITA TE FUNDIT

##### Neni 18

#### Kompetencat e Avokatit te Popullit

Avokati i Popullit kujdeset per zbatimin e ketij ligji.

Kompetencat e Avokatit te Popullit, ne lidhje me te drejten e informimit per dokumentet zyrtare, rregullohen me ligjin nr.8454, date 4.2.1999 "Per Avokatin e Popullit".

Neni 19

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 6 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2409, date 14.7.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani